



Nr. Ref. BD-231/1

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 05 gusht 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN126 Auto Prishtina (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës në shumën totale prej 42,733.35 Euro për dy (2) kreditor në pesë (5) transaksione.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes plotësuese të përkohshme për kreditorët e PRN126 Auto Prishtina në likuidim sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbljedhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes plotësuese të Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN126 Auto Prishtina (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 05 gusht 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-231/2

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 40, 41.4 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 05 gusht 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet raporti plotësues/shtesë i shpërndarjes të përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN092 NSh Eximkos (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës në shumën totale prej 17,544.05 Euro duke përfshirë ATK në dy (2) transaksione.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes përkohshme të pjesshme për kreditorët e PRN092 NSh Eximkos në likuidim sipas nenit 41.4 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmblendhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin plotësues/shtesë të Shpërndarjes të Përkohshme pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN092 NSh Eximkos (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 05 gusht 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-231/3

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 05 gusht 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN046 FAN Zahir Pajaziti (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës në shumën totale prej 713,477.45 Euro për 349 kreditor në 473 transaksione.
- II. Ekzekutimi i pagesave për kreditorët do të ekzekutohen pas pranimit të mjeteve nga Ministria e Financave në emër të Fondeve të Përkohshme të transferuara në buxhetin e Republikës së Kosovës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes të përkohshme për kreditorët e PRN046 FAN Zahir Pajaziti në likuidim sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DHPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin plotësues/shtesë të Shpërndarjes të Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN046 FAN Zahir Pajaziti (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 05 gusht 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-231/4

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 05 gusht 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen të përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRZ071 KB Malisheva (në likuidim) nga Rajoni i Prizrenit, PRZ004-0003 të datës 28.06.2011 i lëshuar në interes të PRZ071 NSh "KB Malisheva" – Malishevë (në likuidim) për pagesën e 24 bujqve për grurin e dorëzuar në PRZ004 NSh "IMBB Silosi" – Xërxë në shumën totale prej 88,173.86€.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes të përkohshme plotësuese për kreditorët e PRZ071 KB Malisheva në likuidim sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmblledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin të Shpërndarjes të Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRZ071 KB Malisheva (në likuidim) nga Rajoni i Prizrenit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 05 gusht 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-231/5

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, dhe), Rregullorja Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 2.5 i Kontratës së Qirasë të nënshkruar në mes të Autoritetit të Likuidimit dhe parashtruesit të kësaj kërkesë dhe Nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 05 gusht 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Ndryshohet/plotësohet vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-230/44 të datës 30 korrik 2025, në raport me pikën I dhe II të dispozitivit të vendimit të Bordit të Drejtorëve, ashtu që tani dispozitivi është si në vijim:

- Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e pjesshëm të kontratës së qirasë tek NSh "NewCo Grand Hotel" Sh.p.k. (në likuidim):

Transferohet obligimi - qiraja mujore prej 1,000.00 €, nga Flamur A. Kelmendi B.L., me emër tregtar N.T.P. "De Bona Auto", si qiramarrës i parkingjeve në NewCo "Grand Hotel", për sipërfaqen prej 202.37 m² (hapësirë mbi tokë – në hyrje të Grand Hotelit), në emër të ADV Facility Management, përfaqësuar nga Granit Gashi, ndërsa pjesa e qirasë mujore në shumën prej 4,798.00 €, për sipërfaqen prej 1,096.09 m² (hapësirë nëntokësore) vazhdon të mbetet në qira në emër të Flamur A. Kelmendi B.L., sipas kontratës ekzistuese dhe anekseve të saj.

- Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë që brenda periudhës deri në 6 muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, të paguajë, përpos qirasë mujore, edhe pjesën e borxhit për si në vijim:
 - a) Flamur A. Kelmendi B.L., me emër tregtar N.T.P. "De Bona Auto", si qiramarrës i parkingjeve në NewCo "Grand Hotel" Sh.p.k., para transferimit të një pjese të kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) në emër të ADV Facility Management, është i obliguar të shlyejë borxhin e papaguar në shumën prej 12,269.36 € (neto), pa përfshirë shpenzimet komunale për gjashtë muaj, ashtu që përpos shumës së kontratës së qirasë të paguajë edhe pjesën prej 2,044.89 Euro për muaj.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e e përmirësimit të vendimit Nr. Ref. Nr. Ref. BD-230/44 të datës 30 korrik 2025, të datës 30 korrik 2025 sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim.



Pala me datës 04 gusht 2024 ka dërguar shkresë shtesë nr. *protokolli 3574-2 Plotësim i kërkesës - nga Flamur Kelmendi (NTP De Bona Auto)*, përmes të cilës ka sqaruar se dëshiron të plotësoj kërkesën e tyre të mëhershme për transfer qiraje sipas Marrëveshjes së partneritetit të tyre.

Meqenëse vendimet e mbledhjes 30.07.2025 veçse ishin nënshkruar dhe dërguar Bordi sipas propozimit të AL-së e pa të arsyeshme të nxjerr vendim për përmirësim të vendimit të kaluar pas që teknikisht i bie që do të ndryshohen shumatat që palët janë dakorduar të i paguajnë për secilën pjesë ndaras dhe këto shuma dallojnë nga shumatat që ishin përcaktuar në memorandumin e kaluar në baze të llogaritjeve tjera. Duke qene se transferimi bëhet me vullnet të palëve dhe palët mund të përcaktojnë pjesët e pagesave në mënyrë vullnetare dhe në interes të Agjencisë është të arkëtojë shumën e njëjtë të mjeteve që ka arkëtuar deri me tani për këto hapësira.

Bazuar në këtë dokumentacion dhe meqenëse çmimi i përgjithshëm i qirasë për muaj mbetet i pandryshuar, propozimi i paraqitur synon vetëm korrigjimin teknik të vendimit të Bordit të Drejtorëve BD-230/44.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 05 gusht 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit